

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Z-0
Nr. l faq. 3 fage
Nr. pages
PRISHTINE

Nr. Prot. 01-334/11
Br. Prot. Prot No.
Data Datum 14.02.2011



Received by:
ZPD/IN/11/0039
14-02-2011

Office of Disciplinary Counsel
Zyra e Prokurorit Disiplinor
Kancelarija disciplinskog tuzioca

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
Zyra e Prokurorit disiplinor
SUDSKI SAVET KOSOVA
Kancelaria Disiplinskog tuzioca
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Office of Dsiiplinary Prosecutors

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Në mes të

Agjencisë kundër korrupsionit (AKK) dhe Zyrës së Prokurorit Disiplinor (ZDP) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit pajtohen si në vijim

1

Agjencia Kundër Korrupsionit dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi krijojnë raporte të partneritetit dhe bashkëpunimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes:

- Shkëmbimit të informatave;
- Bashkëpunimin në hetimin e rasteve korruptive kur pohohet përfshirja e gjyqtareve dhe prokuroreve;
- Ndihmën dhe asistencën teknike të ndërsjellë në proceset e hetimeve preliminare;
- Këshillimin i përbashkët në zgjidhjen e rasteve dhe problemeve të ndryshme që kanë të bëjnë me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në gjykata dhe prokurori;
- Si dhe format e tjera të disponueshme të bashkëpunimit.

2

AKK dhe ZDP do të bashkëpunojnë ngushtë në evidentimin, sigurimin e informacioneve dhe provave relevante të rasteve të deklarimeve të dyshimta të pasurisë të gjyqtareve dhe prokuroreve.

3

ZDP do ti trajtoj me prioritet të gjitha informacionet e pranuar nga AKK.

4

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje pajtohen që të zgjerojnë fushat e bashkëpunimit në rrafshin e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit edhe përmes:

1. Trajnimet e përbashkëta;
2. Pjesëmarrja në seminarët dhe format tjera të avancimit të diturive teorike dhe praktike.

5

Parimi i konfidencialitetit dhe ruajtjes së fshehtësisë të informatave dhe dokumenteve do të zbatohet në përpikëri, duke mënjanuar çfarëdo situatë të konfliktit të mundshëm të kompetencave.

6

Bashkëpunimi do të realizohet në mes të zyrtarëve kontaktues si dhe në pajtueshmëri të plotë me zotimet që dalin nga kjo Marrëveshje.

7

Asnjë nga veprimet e cekura më lart, që adresojnë format e bashkëpunimit ndërinstitucional nuk do të përdoren për qëllime tjera, jashtë mandatit ligjor të AKK dhe ZDP.

8

Kjo marrëveshje shfuqizohet:

- a. Me paralajmërim e njëres palë në afat prej 30 ditësh dhe
- b. Nëse dispozitat e kësaj Marrëveshje shkelen apo keqpërdoren Marrëveshja automatikisht do të shfuqizohet.

9

Kjo Marrëveshje hynë në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga Drejtori i AKK-se dhe Kordinatorit të ZDP.

10

AKK dhe ZDP do të mbajnë nga dy kopje të kësaj Marrëveshje.

Nënshkruesit e kësaj Marrëveshje

Agjencia kundër Korrupsionit


Z. Hasan Preteni-Drejtör

Zyra e Prokurorit Disiplinor


Z. Kadri Begolli-Kordinator